



bujqësore ose të specieve të bimëve që do të mbillen, teknologji ve që do të aplikohen në kultivimin e bimëve dhe përpunimin e produkteve, investimeve në infrastrukturë (kullim, ujtitje, sistemim etj.), të shprehura në tregues fizikë dhe monetarë, të dhëna për burimet e financimit të shprehura në vlerë që garantojnë investimet, ndikimin e veprimtarisë në shtimin e numrit të të punësuarve;

c) Planbизнесin e hollësishëm të aktivitetit që do të ushtrohet;

ç) Studimin për ndikimin në mjedis të projektit;

d) Afatin e qiramarrjes së sipërfaqes së kërkuar, në varësi edhe të kulturave bujqësore ose specieve të bimëve që do të mbillen, por jo më shumë se 30 vjet;

dh) Kohën e fillimit dhe mbarimit të mbjelljes së tokës me kultura bujqësore, në rastin e qiramarrjes së saj për pemëtore, vreshta dhe ullishte;

e) Nivelin e çmimit (lekë/ha në vit) që ofrohet për marrjen me qira të tokës bujqësore;

ë) Vërtetimin se nuk ka detyrime financiare ose ligjore të pashlyera ndaj shtetit.

8. Ofertat paraqiten në një zarf të mbyllur, i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale dhe një fotokopje të dokumentacionit të ofertës, si dhe ku përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik, të interesuar. Në rast se paraqiten grup individësh, kërkesa mund të paraqitet nga një përfaqësues i pajisur me prokurë.

9. Në procesin e hapjes së ofertave marrin pjesë të gjithë anëtarët e BQTB-së dhe subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre, të pajisur me prokurë dhe dokument identifikimi.

10. Kur ofertat nuk plotësojnë kushtet për kualifikim, atëherë ato skualifikohen nga konkurrimi. Ofertat e kualifikuara si të rregullta nga përmbajtja e dokumentacionit të paraqitur vlerësohen në vijim pa praninë e pjesëmarrësve, sipas kritereve të vlerësimit.

11. BQTB-ja harton procesverbalin e zhvillimit të procedurës konkurruese, ku përshkruan ofertuesit, dokumentacionin e paraqitur prej tyre, si dhe ofertuesit e kualifikuar e ata të skualifikuar.

12. BQTB-ja, brenda dy ditëve nga data e hapjes së procedurës konkurruese, shqyrton ofertat e kualifikuara si të rregullta, vlerëson me pikë ofertën, sipas kritereve të vlerësimit, dhe harton vendimin për renditjen e ofertuesve.

13. Fitues i procedurës konkurruese shpallet me vendim të BQTB-së subjekti me më shumë pikë të grumbulluara.

14. Ankimi mund të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në kreun IV, të këtij vendimi.”

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 526, datë 17.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 321, DATË 28.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SIGURINË NË DET, PLAZHE, NË UJËRAT E BRENDSHME NË THELLËSI TË TERRITORIT DHE GJATË USHTRIMIT TË SPORTEVE UJORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008, “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, të ndryshuar, të nenit 4/a, të ligjit nr. 8663, datë 18.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nën 20 NT”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të nenit 3, të ligjit nr. 8905, datë 6.6.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, dhe të ligjit nr. 9734, datë 14.5.2007, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 321, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:



1. Në pikën 3, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronjat “a” dhe “c” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) “Plazh publik” është pronë ekskluzive e shtetit, e hapur për përdorim publik, me ose pa autorizim të pushtetit vendor, në përputhje me aktet ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi, dhe që ofron mjete minimale për përdorim me kushtet e sigurisë dhe të higjienës.

...

c) “Plazh i autorizuar” janë ato zona të plazheve, që janë të autorizuar e të hapura për përdorim publik dhe që ofrojnë mjete minimale për përdorim, me kushtet e sigurisë dhe të higjienës.”.

b) Në fund të shkronjës “ç” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Njësisia “Stacion plazhi” nuk mund të ofrojë shërbim restoranti ose shërbim diskoje.”.

c) Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l”, me këtë përmbajtje:

“l) “Rrugë kalimi”, rruga për të cilën subjektet private, që shfrytëzojnë plazhin publik me autorizim të pushtetit vendor, si dhe subjektet mbajtëse të titullit të pronësisë së pronës pranë plazhit publik, kanë detyrimin ta ndërtojnë atë për kalimin e individëve midis plazhit publik dhe rrugës publike.”.

2. Në kreun II, “Detyrimet e institucioneve përgjegjëse”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “c”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Plazhet, që nuk janë përmendur në shtojcën A-1, nuk mund të jenë objekt autorizimi, por janë të lira për përdorim nga publiku i gjerë dhe nuk mund të pretendohen nga asnjë person i tretë.”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1. Asnjë subjekt privat nuk mund të ndalojë apo të kufizojë, në asnjë formë dhe në asnjë kohë, kalimin e publikut në rrugët që lidhin rrugën publike me plazhin publik. Subjektet, pronarë të pronës pranë plazhit publik, kanë detyrimin për të krijuar kushtet e kalimit lirish të publikut dhe moscenimin në ndonjë formë të kësaj të drejte.

Në rastin e bllokimit të rrugëve ekzistuese nga subjektet mbajtëse të titullit të ligjshëm të pronësisë së pronës pranë plazhit publik apo çdo subjekt

tjetër pretendues, të merren masa të menjëhershme për lirimin e këtyre rrugëve vullnetarisht nga këto subjekte ose të ndërtimit të rrugëve të reja, me parametrat e duhur për të mundësuar aksesin e publikut në plazh.”.

3. Pas pikës 3, të kreut IV, “Dispozita të fundit”, shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Në rast konstatimi të mospërmbushjes së kriterëve të parashikuara në këtë vendim nga ana e subjektit, që ushtron aktivitetin e stacionit të plazhit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka të drejtë të kërkojë anulimin e e kontratës së lidhur si dhe të autorizimit të marrë nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit “Stacion plazhi”.”.

4. Në shtojcën A-1, që i bashkëlidhet vendimit, pas numrit rendor 94 shtohen “Plazhet e Ksamilit”, me numrat rendorë nga 95-105, plazhet e Palasës dhe Rrugëve të Bardha, me numrat rendorë 106-107, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Në fund të shtojcës B-3, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në hapësirën e plazhit të marrë në përdorim për ushtrimin e aktivitetit “Stacion plazhi”, subjekti i autorizuar për të ushtruar këtë aktivitet nuk mund të kryejë punime të tilla, si: gërmime, depozitime inertesh, ndërtim platformash betoni ose strukturash të ngjashme, të cilat nuk janë sezonale.”.

II. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA A

A-1

Plazhet e Ksamilit:

95. Pasqyrat	(Ksamil)
96. Pulëbardhat	(Ksamil)
97. Gjiri i Hartës	(Ksamil)
98. Gjiri i Baxhos	(Ksamil 1)
99. Plazhi	(Ksamil 2)
100. Gjiri Poda	(Ksamil 3)
101. Plazhi i Guvave	(Ksamil 4)
102. Plazhi 4 Ishujt	(Ksamil 5)
103. Plazhi Gjiri Bora- Bora	(Ksamil 6)



104. Plazhi i Ksamilit (Ksamil 7)
 105. Gjiri i Varkave (Ksamil 8)
 106. Plazhi i Palasës
 107. Plazhi i Rugëve të Bardha

VENDIM

Nr. 537, datë 18.6.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
 BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
 KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
 REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
 QEVERISË SË MALIT TË ZI, NË
 KONTEKSTIN E ANËTARËSIMIT NË
 BASHKIMIN EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, në kontekstin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
 Edi Rama**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
 NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
 TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
 QEVERISË SË MALIT TË ZI NË
 KONTEKSTIN E ANËTARËSIMIT NË
 BASHKIMIN EUROPIAN**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (në vijim referuar si "Palët Kontraktuese"):

nisur nga objektivi strategjik për të arritur anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian;

duke mbajtur parasysh rëndësinë e qasjes individuale në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për anëtarësim në BE;

të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të përbashkët për përparimin në arritjen e afirmimit të përhershëm të vlerave europiane në rajon;

duke riafirmuar rëndësinë e reformave politike, institucionale, ekonomike dhe ligjore në arritjen e standardeve të BE-së;

duke mbajtur parasysh përkushtimin e BE-së për të mbështetur reformat në rajon përmes programeve të ndryshme dhe instrumenteve për ndihmë financiare dhe me ekspertë;

të vendosur për të vazhduar zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal;

të vetëdijshëm për rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët me qëllim përshpejtimin e harmonizimit të legjislacionit vendor me *acquis*;

nisur nga konkluzionet e Kryesisë së Këshillit European në Selanik, në Samitin e BE-së dhe të vendeve të përfshira në Procesin e Stabilizim Asociimit të muajit qershor 2003;

të inkurajuar nga konsensusi i rinovuar për zgjerimin, siç përcaktohet në konkluzionet e Kryesisë së Këshillit European të dhjetorit 2006 në Bruksel;

duke përshëndetur konkluzionet e Këshillit European të 29 qershorit 2012 mbi fillimin e negociatave me Malin e Zi dhe dhënien e statusit kandidat Republikës së Shqipërisë nga ana e Këshillit European me 27 qershor 2014;

të gatshëm për rritjen e dialogut të rregullt politik me fokus të veçantë në bashkëpunimin që synon integrimin në strukturat europiane;

duke marrë parasysh të gjitha marrëveshjet dypalëshe të lidhura midis Palëve Kontraktuese;

kanë rënë dakord si më poshtë.

**KAPITULLI I
 DIALOGU POLITIK**

Neni 1

Palët Kontraktuese bien dakord të intensifikojnë dialogun e tyre të rregullt politik me qëllim rritjen e bashkëpunimit në kontekstin e integritimit evropian dhe afirmimit të vlerave europiane në bashkëpunimin dypalësh dhe rajonal.

Neni 2

Dialogu politik do të zhvillohet përmes mbledhjeve të Ministrave të Punëve të Jashtme dhe Integritimit European ose takimeve të përfaqësuesve të tre ministrive në nivel të lartë, çdo vit.